



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P - 105
Prishtinë, më 14,15 dhe 19 mars 2013

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 14, 15 DHE 19 MARS 2013**

Mbledhjen e kryesoi kryetari Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari Xhavit Haliti.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Nait Hasani, Imri Ahmeti, Jakup Krasniqi, Florim Krasniqi, Time Kadrijaj, Emilija Rexhepi, Goran Marinković, Duda Balje, Nijazi Idrizi dhe Teuta Sahatqija, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Berat Buzhala parashtoi pyetje për ministrin Ramë Buja në lidhje me numrin e përgjithshëm të doktorëve të shkencave në Kosovë, dhe atyre që këtë titull e kanë fituar pas vitit 1991 dhe 1999 dhe ku ruhen punimet e doktoraturave.

Ministri Ramë Buja iu përgjigj pyetjes së deputetit Berat Buzhala.

Deputetja Teuta Haxhiu parashtoi pyetje për ministrin Ramë Buja në lidhje me arsyen e ndërprerjes së programit të rikualifikimit të mësimitdhënësve, të cilët e kanë përfunduar Shkollën e Lartë Pedagogjike dhe kohën e vazhdimet të këtij programi.

Ministri Ramë Buja iu përgjigj pyetjes së deputetes Teuta Haxhiu.

Deputetja Alma Lama parashtoi pyetje për ministren Vlora Çitaku në lidhje me përkthimin e *acquis communautaire*, nëse do të merret i gatshëm nga Shqipëria, apo do të përkthehet nga Ministria e Integrimeve Evropiane.

Ministria Vlora Çitaku nuk ishte e pranishme në sallë.

Deputeti Halit Krasniqi parashtoi pyetje për ministrin Hajredin Kuçi në lidhje me të dhënat për praninë e personave në sistemin aktual të drejtësisë, të cilët kanë ushtruar pozitat e gjykatësve, prokurorëve dhe të personelit të burgjeve në periudhën e paraluftës, e që kanë persekutuar qytetarë të Kosovës.

Ministri Hajredin Kuçi iu përgjigj pyetjes së deputetit Halit Krasniqi.

Deputeti Mursel Halili parashtoi pyetje për ministrin Dardan Gashi në lidhje me atë se a janë marrë masa nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për vënien e pikave të krizës në territorin e Kosovës për t'i parandaluar derdhjet e rrjedhës së lumenjve, rrëshqitjes së gurëve në rrugë dhe ortekëve të borës gjatë dimrit.

Ministri Dardan Gashi nuk ishte e pranishëm në sallë.

Deputeti Visar Ymeri parashtoi pyetje për ministrin Besim Beqaj në lidhje me arsyen e subvencionimit të kompanisë kosovare për Distributim dhe Furnizim, pas nënshkrimit të kontratës për shitjen e kësaj ndërmarrjeje.

Ministri Besim Beqaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Visar Ymeri.

Deputeti Visar Ymeri parashtoi pyetje për ministrin Besim Beqaj në lidhje me një deklaram të ministrit për rristurimin e reformave në ekonominë e vendit.

Ministri Besim Beqaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Visar Ymeri.

Deputetja Albulena Haxhiu parashtoi pyetje për ministrin Hajredin Kuçi në lidhje me atë se a e konsideroni diskriminues vendimin e Qeverisë lidhur me kompensimin e stimulimeve dhe shtesave për prokurorët specialë dhe zyrtarët e Prokurorisë Speciale, në relacion me prokurorët e Prokurorisë Themelore, të Apelit dhe Prokurorisë së Shtetit.

Ministri Hajredin Kuçi iu përgjigj pyetjes së deputetes Albulena Haxhiu.

Deputeti Halit Krasniqi parashtoi pyetje për ministrin Bajram Rexhepi në lidhje me atë se a ka të dhëna ministria për praninë e kontingjenteve të ndryshme të karakterit të sigurisë të shtetit të Serbisë, të akomoduar në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës.

Ministri Bajram Rexhepi iu përgjigj pyetjes së deputetit Halit Krasniqi.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

3. Shqyrtimi i amendamenteve 23 dhe 24 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të propozuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës

4. Zgjedhja e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe për familjarët e tyre,

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë për Krahësim dhe Verifikim të Pronës,

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për produkte medicinale dhe pajisje medicinale,

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për blegtorinë,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ujërat e Kosovës,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës.

3. Shqyrtimi i amendamenteve 23 dhe 24 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të propozuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Qeveria e Kosovës, në pajtim me nenin 144 paragrafi 1 të Kushtetutës, ka propozuar amendamentet 23 dhe 24 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Amendamentet e lartshënuara, kryetari i Kuvendit ia kishte adresuar Gjykatës Kushtetuese për të vlerësuar nëse të njëjtat e pakësojnë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në kapitullin II të Kushtetutës.

Komisioni për Legjislacion i ka shqyrtuar amendamentet kushtetuese, të propozuara nga Qeveria e Kosovës, si dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Pastaj, kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që të marrë fjalën.

Zëvendëskryeministri dhe ministër i Drejtësisë, **Hajredin Kuçi**, tha se arsyeja e procedimit të amendamentit nr. 24 qëndron në përzgjedhjen e Gjyqësorit krejtësisht në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me rekomandimin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, rekomandimi që ka të bëjë me pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarëve.

Me këtë parashihet se autoriteti, i cili merr vendimin për përzgjedhjen në karrierën e gjyqtarëve duhet të jetë i pavarur nga pushteti dhe administrata, në mënyrë që të sigurohet pavarësia e tij, rregullat dhe ligjet duhet të sigurojnë, që për shembull një anëtar i tij, që zgjidhet në Gjyqësor, të vijë nga një trup, që vendos kryesisht apo në shumicë nga gjyqtarët.

Në vazhdim ai e arsyetoi amendamentin nr. 23, që ka të bëjë me Instituti i Amnistisë, i cili është kërkuar nga pjesë të ndryshme të shoqërisë në Republikën e Kosovës, megjithatë, për shkak të historisë sonë të trazuar, situatës së ndjeshme politike dhe në përgjithësi të nivelit të stabilitetit të vendit tonë, shpeshherë deri më tani është konsideruar që kjo nuk është e mundur të arrihet politikisht dhe shpeshherë është penguar Kuvendi i Republikës së Kosovës apo institucionet tjera, ta përfshijnë këtë qoftë në Kushtetutë, apo në ligje të veçanta.

Amnistia është një institut, nëpërmjet të cilit kategori të ndryshme personash të dënuar dhe kategori të caktuara të veprave penale lirohen pjesërisht apo krejtësisht nga vuajtja e dënimit. Duhet bërë me dije, për dallim nga falja që është institut i faljes së dënimit për persona të caktuar dhe është kompetencë e presidentit të Republikës së Kosovës, amnistia është falje për kategori dhe vepra të caktuara, që është kompetencë e Kuvendit të Republikës së Kosovës, theksoi ai.

Në fund, ai i ftoi deputetët për miratimin e amendamenteve në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: **Arben Gashi**, në emër të Komisionit për Legjislacion; **Arsim Bajrami**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; **Vjosa Osmani**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; **Albulena Haxhiu**, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; **Myzejene Selmani**, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re; **Jasmina Zhivković**, në emër të Grupit Parlamentar SLS; **Myfera Shinik**, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe **Nait Hasani**, **Arben Gashi**, **Hydajet Hyseni**, **Gëzim Kelmendi** dhe kryetari i Kuvendit, **Jakup Krasniqi**, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim, kryetari i njoftoi deputetët për procedurën e votimit, me të cilën parashihet se çdo ndryshim në Kushtetutën e Kosovës kërkon miratimin e 2/3-ve të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë edhe 2/3 e të gjithë deputetëve të Kuvendit, që mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve, që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës, që do të thotë se nevojiten 80 vota, përfshirë këtu 14 vota të komuniteteve të tjera.

Kryetari e hodhi në votim amendamentin 23 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 108,
Kundër ----- 0,
Abstenime----- 0.

Më pas, kryetari e hodhi në votim amendamentin 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 67,
Kundër----- 34,
Abstenime----- 1.

Pas shikimit të rezultateve të votimit elektronik, Kryetari konstatoi se Kuvendi për amendamentin nr. 23 mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet amendamenti nr. 23 i Kushtetues së Republikës së Kosovës, si në vijim:

Në nenin 65, pas pikës (14) shtohet pika (15), me tekstin si vijon: “(15) jep amnisti me ligj përkatës, i cili miratohet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit”.

2. Ndryshimet kushtetuese hyjnë në fuqi menjëherë pas miratimit të tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ndërsa, për amendamentin nr. 24, Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Nuk miratohet amendamenti nr. 24 për ndryshimin e nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

4. Zgjedhja e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Deputetja **Safete Hadërgjonaj**, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, e arsyetoi raportin për përzgjedhjen e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Ajo tha se dy kandidatët e propozuar nga Paneli i Bordit të Bankës Qendrore, Bedri Hamza dhe Gani Gërguri, i plotësojnë kriteret formalo-juridike të parapara në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës për t'u zgjedhur guvernator.

Më tej, deputetja Hadërgjonaj i rekomandoi Kuvendit që ta përzgjedhë njërin prej dy kandidatëve të lartpërmendur për pozitën e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e përzgjedhjes së kandidatëve për guvernator të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadërgjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Koalicionit Kosova e Re; Jelena Bontiq, në emër të Grupit Parlamentar SLS, ndërsa Myfera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6”, si dhe deputetët: Berat Buzhala, Hydajet Hyseni dhe Muhamet Mustafa, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, deputetët e Grupit Parlamentar të LDK-së dhe Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” e lëshuan sallën e seancave.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 70 deputetë.

Në vazhdim, kryetari tha se meqë janë të propozuar dy kandidatë për pozitën e guvernatorit, me ligj nuk është përcaktuar mënyra dhe forma e përzgjedhjes. Ai propozoi që votimi të jetë i fshehtë, ndërsa zgjedhja bëhet me shumicën e votave të deputetëve që janë të pranishëm dhe që votojnë.

Ai kërkoi nga deputetët që të deklarohen për formën e votimit.

Kuvendi me shumicë absolute e miratoi propozimin për votim të fshehtë për përzgjedhjen e guvernatorit të BQK.

Për zbatimin e procedurës së votimit, kryetari propozoi që të formohet një Komision votues, i përbërë nga një anëtar prej secilit grup parlamentar, i mbështetur nga zyrtarët e Administratës.

Ai i ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar për Komisionin votues.

Pas propozimit të kandidatëve nga grupet parlamentare, kryetari e hodhi në votim miratimin e Komisionit votues.

Kuvendi, me shumicë absolute e miratoi propozimin për formimin e Komisionit votues në këtë përbërje:

1. Ramiz Lladrovci, në emër të GP të PDK-së,
2. Time Kadrijaj, në emër të GP të PDK-së,
3. Sevdije Lama, në emër të GP të KKR-së,
4. Jelena Bontiq, në emër të GP të SLS-së,
5. Duda Balje, në emër të GP “6+”.

Pastaj, kryetari i ftoi një nga një deputetët për të votuar për guvernatorin e BQK-së.

Pas procedurës së votimit dhe numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti deputeti Ramiz Lladrovci.

Deputeti Lladrovci tha se në votim kanë marrë pjesë 67 deputetë. Rezultati i votimit është si në vijim:

1. Bedri Hamza, ka fituar 58 vota,
2. Gani Gërguri, ka fituar 3 vota dhe

Të pavlefshme janë 6 fletëvotime.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Bedri HAMZA zgjidhet guvernator i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.
2. Emri i kandidatit të zgjedhur nga Kuvendi, z. Bedri Hamza, i procedohet Presidentes së Republikës së Kosovës për miratim dhe emërim në pozitën e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.
3. Mandati i guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës është pesë (5) vjet.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe për familjarët e tyre

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e GP të Lëvizjes “Vetëvendosje” që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe për familjarët e tyre.

Deputetja **Albana Gashi**, në emër të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”, tha se ky projektligj ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe për familjarët e tyre.

Në vazhdim, ajo tha se ligji aktual nuk përfshin edhe viktimat e abuzimit seksual e të dhunimit. E drejta themelore e tyre është për t’u njohur si kategori e veçantë dhe të konsiderohen edhe

detyrime tjera institucionale. Më tej, theksoi se përdhunimi është formë e krimit kundër njerëzimit, ndërsa statuti i Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës, i miratuar nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së, e sanksionon torturën dhe përdhunimin si forma të rënda të krimit kundër njerëzimit.

Ajo më pas u fokusua në raportin e organizatës ndërkombëtare Human Rights Watch për shifrat e femrave të dhunuara gjatë luftës së fundit në Kosovë nga regjimi serb, i përmendi edhe debatet në Kuvend lidhur me këtë çështje, çështjet e debatuar në Samitin Ndërkombëtar të Gruas, mbajtur kohë më parë në Prishtinë, si dhe një varg konventash ndërkombëtare, të cilat e rregullojnë fushën e të drejtave të njeriut.

Në fund, ajo i ftoi deputetët për miratimin e projektligjit në parim.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe për familjarët e tyre.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Fikrim Damka, në emër të Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale; Safete Hadërgjonaj, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa; Flora Brovina, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Nazane Breca, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Gëzim Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Blerta Deliu-Kodra, Vjosa Osmani, Alma Lama, Suzan Novobërdaliu, Nait Hasani, Salih Morina, Visar Ymeri, Donika Kadaj-Bujupi, Bekim Haxhiu, Rita Hajzeraj-Beqaj, Armend Zemaj, Rexhep Selimi, Fikrim Damka, Naser Osmani, Glauk Konjufca, Ardian Gjini, Shaip Muja, Liburn Aliu, Flora Brovina, Ahmet Isufi dhe Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim rekomandimin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mosmiratimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe për familjarët e tyre.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 30,
Kundër -----33,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi rekomandimin Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Andaj, kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet, në parim, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe për familjarët e tyre.

2. Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si Komision Funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për Agjencinë për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës.

Zv/kryeministrja Edita Tahiri, në emër të Qeverisë së Kosovës, tha se ky projektligj përcakton organizimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës.

Në vazhdim, ajo theksoi se fushëveprimi i projektligjit ka të bëjë me zgjidhjet e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe pronën private komerciale, si dhe krahaskimin dhe zgjidhjen e dallimeve ndërmjet dokumenteve kadastrale origjinale të marra në Kosovë nga autoritetet serbe para qershorit të vitit 1999 dhe të dokumenteve kadastrale aktuale në Republikën e Kosovës për pronën private, pronën private komerciale dhe pronën private të bashkësive fetare.

Ajo më pas u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit dhe i ftoi deputetët për miratimin e tij në parim.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për Agjencinë për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Arben Gashi, në emër të Komisionit Funksional për Legjislacion dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Halit Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Gëzim Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, ndërsa Petar Miletqi, në emër të Grupit Parlamentar SLS, si dhe Hashim Deshishku, Armend Zemaj, zv/kryeministrja Edita Tahiri dhe Albulena Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi theksoi se në sallë janë të pranishëm 55 deputetë dhe nuk ka kuorum për t'i vazhduar punimet e sotme të mbledhjes plenare.

Kryesuesi konstatoi përfundimin e mbledhjes së sotme, ndërsa vazhdimi i mbledhjes plenare do të bëhet të premtën, më 15 mars 2013, në orën 10.00.

Kryesuesi i përfundoi punimet e mbledhjes plenare në orën 17:55.

E premte, më 15 mars 2013

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 14 mars 2013

Mbledhjen e kryesoi kryetari Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari Xhavit Haliti.

Kryetari e deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare, të filluar më 14 mars 2013.

Në vazhdim, lidhur me rendin e ditës, fjalën e kërkoi kryetari i GP të LDK-së.

Ismet Beqiri, propozoi që në vazhdim Kuvendi t'i fillojë punimet sipas agjendës së paraparë për mbledhjen e rregullt plenare të datës 15 mars 2013, ku në rend dite janë dy debate parlamentare.

Në lidhje me propozimin e deputetit Ismet Beqiri, kryetari kërkoi deklarinimin e kryetarëve të grupeve parlamentare.

Për grupet parlamentare u deklaruan: Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re; Sasha Milosavleviq, në emër të Grupit Parlamentar SLS; Myfera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Ismet Beqiri, Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim, kryetari e hodhi në votim propozimin e deputetit Ismet Beqiri që Kuvendi të fillojë punimet sipas agjendës së paraparë për mbledhjen e rregullt plenare të datës 15 mars 2013.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 47,
Kundër -----35,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi propozimin për fillimin e mbledhjes së rregullt plenare, sipas agjendës së paraparë më 15 mars 2013.

Kryetari konstatoi se vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 14 mars 2013, do të bëhet pas përfundimit të punimeve të mbledhjes së rregullt plenare, të datës 15 mars 2013.

* * *

E martë, më 19 mars 2013

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 14 dhe 15 mars 2013

Mbledhjen e kryesoi kryetari Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari Xhavit Haliti.

Kryetari e deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare, të filluar më 14 dhe 15 mars 2013.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 64 deputetë dhe procedoi me pikat e mbetura të rendit të ditës, si në vijim:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë për Krahësim dhe Verifikim të Pronës

Kryetari tha se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në mbledhjen plenare të mbajtur më 14 mars 2013, mirëpo në mungesë të kuorumit nuk ka qenë e mundur të procedohet me votim.

Kryetari e hodhi në votim Projektligjin për Agjencinë për Krahësim dhe Verifikim të Pronës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 49,
Kundër ----- 23,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Agjencinë për Krahësim dhe Verifikim të Pronës.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si Komision Funkcional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për produkte medicinale dhe pajisje medicinale

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për produkte medicinale dhe pajisje medicinale.

Ministri Ferid Agani, në emër të Qeverisë së Kosovës, tha se ky projektligj i përcakton rregullat dhe procedurat për prodhimin, kontrollin e cilësisë, klasifikimin, autorizimin për marketing, regjistrimin, importin, tregtinë, hulumtimet klinike dhe përcaktimin e çmimeve të produkteve dhe pajisjeve medicinale.

Në vazhdim, ai theksoi se këtij ligji i nënshtrohen të gjitha autoritetet publike, ndërmarrjet publike e private, si dhe personat juridikë e fizikë që merren me prodhimin dhe tregtimin e produkteve dhe pajisjeve medicinale.

Ai më pas u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit dhe i ftoi deputetët për miratimin e tij në parim.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për produkte medicinale dhe pajisje medicinale.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Fikrim Damka, në emër të Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale; Salihe Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Bahri Thaçi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Gëzim Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re; Myfera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Aurora Bakalli, Lutfi Zharku, Rita Hajzeraj-Beqaj, Xhavit Haliti, Shaip Muja dhe ministri Ferid Agani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për produktet medicinale dhe pajisjet medicinale.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 63,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për produktet medicinale dhe pajisjet medicinale.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale si Komision Funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

Ministri Dardan Gashi tha se qëllimi i këtij projektligji është krijimi i procedurave për legalizimin e ndërtimeve pa leje në Republikën e Kosovës.

Në vazhdim, ai theksoi se ky projektligj parasheh përshtatshmërinë e ndërtimeve pa leje me planifikimin hapësinor të Kosovës, që nënkupton rrënimin e ndërtimeve pa leje, që janë në kundërshtim me planin hapësinor dhe legalizimin e ndërtimeve pa leje që nuk e pengojnë Planin Hapësinor të Kosovës, si dhe përcaktimin e organeve kompetente për legalizimin e ndërtimeve pa leje.

Ai më pas u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit dhe i ftoi deputetët për miratimin e tij në parim.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Nait Hasani, në emër të Komisionit Funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor; Nijazi Idrizi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Salih Morina, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Daut Haradinaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Sevdije Lama, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re; Jasmina Zhivković, në emër të Grupit Parlamentar SLS; Rasim Demiri, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Bekim Haxhiu dhe Sadri Ferati, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 54,
Kundër ----- 9,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si Komision Funkcional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për blegtorinë

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për blegtorinë.

Ministri Blerand Stavileci tha se arsyeja e hartimit të këtij projektligji është se janë krijuar rrethana të reja politike-ekonomike në Kosovë për avancimin, mbrojtjen, përmirësimin dhe ruajtjen e cilësive të burimeve gjenetike të kafshëve, me synim nxitjen e fermerëve për shtimin e prodhimeve blegtorale, përmirësimin e cilësisë së prodhimeve dhe ruajtjen e ndryshueshmërisë gjenetike të kafshëve blegtorale.

Ai më pas u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit dhe i ftoi deputetët për miratimin e tij në parim.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për blegtorinë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Nait Hasani, në emër të Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor; Nijazi Idrizi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Afërdita Berisha - Shaqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Liburn Aliu - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Kimete Bajraktari - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Sevdije Lama - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re; Rasim Demiri - në emër të Grupit Parlamentar ‘6+’ si dhe Shaip Muja, Xhevdet Neziraj, Emilija Rexhepi dhe Xhavit Haliti diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për blegtorinë. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 62,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për blegtorinë.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si Komision Funkcional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funkcional raportues për Projektligjin për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme.

Raportin me rekomandime në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, e paraqiti kryetari i këtij komisioni, deputeti Zenun Pajaziti, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Kryetari, hodhi në votim veç e veç amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Kuvendi i miratoi amendamentet nr: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18,19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39 dhe 40.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 67,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ujërat e Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL raportues për Projektligjin për ujërat e Kosovës.

Raportin me rekomandime, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, e paraqiti kryetari i këtij komisioni, deputeti Nait Hasani, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Në lidhje me amendamentin nr. 52 diskutoi deputeti Armend Zemaj, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Kryetari i hodhi në votim veç e veç amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Kuvendi i miratoi amendamentet nr: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18,19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39,40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51 dhe 52.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 57,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për ujërat e Kosovës.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL raportues për Projektligjin për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës.

Raportin me rekomandime, në emër të Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, e paraqiti kryetari i këtij komisioni, deputeti Nait Hasani, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Daut Haradinaj, Sali Morina dhe Liburn Aliu, diskutimi i plotë i të cilëve është dhënë në transkript.

Kryetari i hodhi në votim veç e veç amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Kuvendi i miratoi amendamentet nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13.
Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 65,
Kundër----- 5,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës.

* * *

Në fund të mbledhjes, për mospraninë e shpeshtë të deputetëve në seancë, kryetari kërkoi nga Komisioni për Legjislacion që gjatë hartimit të Projektligjit për përgjegjësitë dhe të drejtat e deputetit ta normojë edhe pjesën obligative të deputetëve për të marrë pjesë në seanca plenare. Punën primare deputetët duhen ta kenë në Kuvend. Diskutimi i kryetarit është dhënë i plotë në transkript.

Kryetari i mbylli punimet e mbledhjes plenare, në orën 14:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*